



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË**

Tiranë, më 14.11.2017

Dokument parlamentar

R A P O R T

**për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”
(në parim)**

Drejtuar: *Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat
Seancës Plenare*

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në mbledhjet e tij të datave dhe 10 nëntor 13, 2017, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”, në parim.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e shqyrtimit në parim të këtij projektligji dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Financave, Zëvendësministri i Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, si dhe specialistë të këtyre ministrive.

Komisioni, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-39 dhe 80 të Rregullores, shqyrtoi projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2018”, për pjesën që shprehet për shpenzimet dhe të ardhurat për këto ministri.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh se, buxheti i planifikuar për këtë ministri për vitin 2018, i mbulon të gjitha nevojat për programet buxhetore dhe për realizimin e programit politik qeverisës dhe se, ky buxhet, për vitin 2018 parashikohet të jetë 73 miliard e 79 milion lekë (përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën 11 miliard e 906 milion lekë) ose 4.429% i PPB. Në këtë buxhet janë të përfshira edhe financimet për spitalin e Traumës(917.5 milion lekë) si dhe financimet për Njësinë e Helikopterëve(140 milion lekë).

Në këtë komision, ministrja theksoi ndarjen e buxhetit në dy fushat e zbatimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga ku, për Shëndetësinë do të financohen për vitin 2018, 49 miliard e 294 milion lekë ose 2.988% i PBB, për Mbrojtjen Sociale do të financohen 23 miliard 785 milion e 750 mijë lekë ose 1.445% kundrejt PPB.

Në prezantimin e këtij buxheti për këtë Ministri u pasqyrua shpërndarja e financimeve si me poshtë:

- financon mbulimin universal për kontrollin bazë mjekësor për grupmoshën 35 – 70 vjeç, vizitat tek mjeku i familjes, rimbursimin e barnave, vizitat dhe ekzaminimet tek mjeku specialist sipas hallkave të sistemit të referimit për të gjithë popullsinë rezidente në vend.

- do të financojë rikonstrukcionin tërësor dhe pajisjen e rreth 80 qendrave shëndetësore dhe ambulancave në të gjithë vendin.

- financon një shërbim të urgjencës mjekësore 24/7 në territor të shpejtë, të fuqizuar dhe më të specializuar.

- financon shërbimin e urgjencës kardiake dhe celebrale-vaskulare 24/7.

- financon plotësisht protezat ortopedike dhe neurokirurgjike.

- financon fillimin e projektit për modernizimin radikal të QSUT në shërbimet e kirurgjisë së përgjithshme, pediatriisë dhe ndërtimin e një spitali të ri modern të sëmundjeve të brendshme.

- vazhdon financimin e partneritetit publik-privat duke përfshirë edhe investimet e tyre.

- do të financojë rikonstrukcione, ndërtime të reja dhe kompletim me pajisje mjekësore në disa spitale Rajonale të vendit.

Investimet për vitin 2018 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë parashikuar për investime 2 miliard e 919 milion e 200 mijë lekë, nga të cilat investime me financim të brendshëm 1 miliard e 978 milion e 950 lekë dhe me financim të huaj 939 milion e 200 mijë lekë.

Shërbimi parësor do të vazhdojnë financimet në kuadër të Projektit të “5 Poliklinikave”:

a) Për pajisje laboratorike për poliklinikat e Tiranës dhe Korçës me vlerë 1 milion euro,

b) Për ristrukturimin e poliklinikave të Gjirokastrës dhe Peshkopisë me vlerë 700 mijë euro.

c) Pajisje mjekësore dhe mobilimi për poliklinikat e Gjirokastrës dhe Peshkopisë me vlerë 700 mijë euro.

Për pjesën që i takon Mbrojtjes Sociale, në prezantimin që bënë përfaqësuesit e kësaj ministrie, u theksua se përkujdesja sociale ka një buxhet vjetor prej 20.5 miliardë lekë e cila shpërndahet në;

Ndihma Ekonomike është parashikuar 4.7 miliardë lekë dhe do të ndikojë për zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, do të eliminojë kriteret përjashtuese, do të lehtësojë dokumentacionin për qytetarët në nevojë.

Për personat me aftësi të kufizuar, janë parashikuar 15.8 miliardë lekë.

Vënia në zbatim e sistemit të ri të vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social duke rritur me 4.5% numrin e përfituesve që realisht u takon dhe duke ulur me 10% rastet abuzive;

Për pagat, për vitin 2018 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale parashikon të zbatojë edhe disa politika më të shenjëstruara për shpërblimin e punës së mjekëve sidomos në ato zona ku kemi mungesë mjekësh. Për motivimin e dërgimit të mjekëve në këto zona Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale do të paguaje paga dhe bonuse motivuese me vlera 200,000-250,000 lekë në muaj, si dhe rritjen e incentivave financiare për mjekë specialist që ofrojnë shërbim.

Deputetët ngritën një sërë çështjesh në lidhje me mjaftueshmërinë e fondeve të parashikuara në buxhet për realizimin e të gjitha programeve të kësaj ministrie e kryesisht për skemën e rimbursimit të barnave dhe mungesa e tyre, largimin e kompanive me emër në fushën e farmaceutikës, personelin mjekësor, shërbimin e urgjencës mjekësore, investimet që parashikohen të bëhen gjatë vitit 2018.

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Përfaqësuesit e kësaj ministrie, shpjeguan nëpërmjet një informacioni përmbledhës mbi buxhetin e Programeve të Punësimit dhe Formimit Profesional për vitin 2018.

U theksua se programi i Qeverisë 2017-2021 e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës dhe se punësimi ka qenë një prioritet i mandatit të parë, e reflektuar kjo në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014 – 2020. Masat e zbatuara në kuadrin e SKPA kanë pasur impakt pozitiv tek pjesëmarrja në tregun e punës dhe tek punësimi në përgjithësi.

Përfaqësuesit e kësaj Ministrie theksuan drejtimet kryesore të ndërhyrjeve në këtë buxhet, konkretisht për punësimin dhe formimin profesional në këto aspekte:

-Reformimi i shërbimeve të punësimit për vendosjen e sistemit të ri të shërbimit, duke përmirësuar ndjeshëm eficiencën dhe targetimin e politikave të punësimit.

-Përfshirjen e punëkërkesve të papunë në programe aktive të punësimit.

-Programet e nxitjes që do të zbatohen në vitin 2018 duke mundësuar punësimin e mbi 5000 punëkërkesve të papunë ku rreth 60% do të jenë femra dhe 55% të rinj si dhe grupet të cilat nxiten me përparësi do të jenë të rinjtë, gratë, romët, personat me aftësi të kufizuara, jetimët dhe grupe të tjera të cilat kanë vështirësi për tu përfshirë në tregun e punës.

Për shërbimin Kombëtar i Punësimit ka një shpërndarje fondi prej 82 milion lekësh. Programet e nxitjes së punësimit, në vitin 2018, 5% ose rreth 5000 e punëkërkesve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit, do të jenë përfitues në programet e nxitjes së punësimit. Fondi i parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2018 është 490 milion lekë. Ky është dhe një nga indikatorët e mbështetjes buxhetore për t'u arritur brenda vitit 2018.

Bazuar në programin i mbështetjes me të ardhura, në këtë buxhet, pagesa e papunësisë përfaqëson një nivel bazë të barabartë me 11.000 lekë në muaj për çdo përfitues, dhe për herë të parë, kjo pagesë u bë sa 50% e pagës minimale. Gjithashtu paguhet e ardhura e papunësisë, në varësi të periudhës së kontributit në sigurimet shoqërore. Bashkë me shtesat për fëmijët në ngarkim, mesatarisht 1 person mund të përfitojë pagesë papunësie në masën 12.500 lekë në muaj.

Gjatë diskutimeve në komision, deputetët, anëtar të këtij komisioni, bënë pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë rreth papunësisë, zyrave të punës, emigracionit në rritje, , politikat dhe strategjitë e reja për Personat me Aftësi të kufizuara, politikat e të rinjve për punësimet e tyre, matësi i tregut të punës, etj.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Të ftuarit për të dhënë shpjegime rreth buxhetit 2018, pasi paraqitën arritjet e deritanishme në fushën e rinisë, raportuan për synimet e tyre, si krijimin e Qendrave Rajonale Rinore në tre qytete të ndryshme të vendit si institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe programeve rinore, themelimi i Zyrës për Bashkëpunim Rajonal të të Rinjve për Ballkanin Perëndimor (ZRBR) dhe se do të zhvillojë dhe administrojë politika kombëtare në fushën e rinisë me qëllim përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, punësimin e të rinjve, arsimin profesional, praktikën mësimore, ngritjen e qendrave rinore, mbrojtjen e shëndetit të të rinjve, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sociale kulturore dhe proceset vendimmarrëse.

Gjatë prezantimit, u theksua vazhdimësia e zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Rininë për periudhën 2015-2020, i cili ka si qëllim zhvillimin dhe koordinimin e politikave

ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse.

Zëvendësministri i kësaj Ministrie shpjegoi buxhetin i dedikuar për Programin e Rinisë për vitin 2018, i cili është i shpërndarë në këto zëra:

- Mbështetja financiare për personelin e Qendrës Rinore, 24 milionë lekë.
- Financimin e aktiviteteve rinore, 48 milion leke.
- Financimin e kontributit sipas marrëveshjes për Zyrën Rinore, 24 milionë lekë.

Anëtarët e komisionit drejtuan pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë në lidhje me aktet nënligjore për vullnetarizmin, politikat dhe strategjitë e reja për të rinjtë, kryesisht në zonat rurale të vendit, karta e të rinjve dhe funksionimi real i saj dhe problematika të tjera që shqetësojnë këtë grup.

Opozita votoi kundër në parim projektligjin, duke argumentuar se ky është një buxheti i rrënuar nga pikëpamja e ideve. Projektbuxheti i vitit 2018 është një buxhet që mbështet klientët e qeverisë dhe oligarkët, me rezultat përfundimtar pasurimin e qeverisë dhe rrënimin e shtresave të gjera, të cilat nuk e gjejnë veten të përfaqësuara në këtë buxhet. Ky projektligj thellon dukshëm papunësinë dhe varfërinë në vend. Të gjitha programet e buxhetit që trajtojnë çështjet e mëdha si papunësia, arsimi profesional, shëndetësia kanë shifra qesharake të papërfillshme.

Paketa *fason* është zhdukur nga buxheti i shtetit. Në shëndetësi nuk ka asnjë objekt të ri, i cili të financohet në mënyrë të dukshme dhe po e njëjta gjë ndodh edhe me arsimin. Ky është një buxhet që stimulon shqiptarët dhe sidomos të rinjtë që të largohen nga Shqipëria.

Komisioni, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin dhe ra dakord, që raporti t'i dërgohet Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

KRYETARI

Petrit VASILI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË**

Tiranë, më 21.11.2017

Dokument parlamentar

R A P O R T

**për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”
(nen për nen)**

Drejtuar: *Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat
Seancës Plenare*

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2018”, në mbledhjet e tij të datës 20 dhe 21 nëntor 2017 shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”, nen për nen.

Të ftuar për të marrë pjesë në diskutim dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin: Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe specialistë të kësaj ministrie, Zëvendësministrja e Financave dhe Ekonomisë dhe specialistë të kësaj ministrie si dhe specialistë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar nenet 32-39 dhe nenit 80 të Rregullores së Kuvendit, brenda fushës së tij të përgjegjësisë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, Ministrinë përkatëse nuk shprehën kërkesa për shtesa apo ndryshime në programet e tyre buxhetore.

Komisioni, bazuar në nenin 36 dhe 80 të Rregullores, zhvilloi dy seanca dëgjimore publike, më datë 14 dhe 15 nëntor 2017 me përfaqësues të ministrive të linjës dhe me përfaqësues të Avokatit të Popullit, organizatave jofitimprurëse që veprojnë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe fëmijëve jetimë, të personave me aftësi të kufizuara, personave që

vuajnë nga sëmundja e diabetit, talasemisë, ish-të përndjekurve politikë, organizatave të romëve dhe egjiptianëve, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, etj.

Pasi dëgjoi dhe diskutoi mbi propozimet konkrete të bëra nga përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse të sipërpërmendura, Komisioni ra dakord që t'i rekomandojë Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, që të vlerësojë mundësinë e shtesave të fondeve në projektbuxhet për:

Në programet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- Të parashikohen 40 milion lekë për Qendrën Kombëtare të Rehabilitimit të të Verbërve, për financimin e kurseve të kompjuterit, mësimit të gjuhës *brail*, trainimet në fushën e mikro dhe makroambientit, mësimit të gjuhëve të huaja, formimit profesional, etj.
- Të parashikohet edhe hendeku financiar i pambuluar prej 221,497,000 lekë për të mundësuar realizimin e aktiviteteve të parashikuara nga Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Të parashikohen fonde për pagat e punonjësve për të punësuar, punonjësit e fëmijëve sipas standardit të parashikuar, në zbatim të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku të paktën në çdo Bashki të ketë një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për 3000 fëmijë”.
- Të parashikohet një fond prej 200 milion lekë në lidhje me indeksimin e ndihmës së paaftësisë për invalidët e punës, për 3 vite të paindeksuara.
- Të parashikohet një fond për indeksimin e pagesës së aftësisë së kufizuar për paraplegjikët dhe tetraplegjikët për periudhën 2007 deri 2012, pasi nuk u është bërë indeksimi për këtë periudhë.
- Të rimbursohet analiza laboratorike gjenetike për vërtetimin e plotë të Sindromës Down, tek fëmijët e lindur me këtë sindromë.

Në programet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:

- Të parashikohet një shtesë fondi në masën 420 milion lekë, për shtesë në pensionin e invaliditetit, për ta njehsuar këtë shtesë me shtesën që i janë bërë pensione ve të pleqërisë.

Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin për buxhetin e vitit 2018.

Anëtarët e opozitës votuan kundër nen për nen dhe në tërësi.

ZV/KRYETARE

Elisa SPIROPALI